**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

**Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova**

---

# PLANI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2025

## Përmbledhja ekzekutive

Ky plan i performancës ka për qëllim të ofrojë drejtimin dhe mundësojë monitorimin e përmbushjes së misionit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Plani reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për sektorin e shëndetësisë, të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025, Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2032, Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), Strategjinë Sektoriale Shëndetësore dhe Planin e Veprimit 2025 - 2030, Planin e Veprimit për Parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje për pandemitë me patogjenë respiratorë 2024-2026 dhe Planin e veprimit për Siguri Shëndetësore 2024-2026. Objektivat e Planit të Performancës 2025 po ashtu janë në pajtim me Ligjin për Shëndetësi, Ligjin për Shëndetësi Publike, si dhe aktet tjera juridike në fuqi që ndërlidhen me fushë veprimtarinë e IKSHPK.

Objektiva 1. Përmirësimi i cilësisë dhe i qasjes në shërbime shëndetësore
Objektiva 2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit
Objektiva 3. Siguria  Shëndetësore

IKSHPK për vitin 2025 ka të miratuara 306 pozita, prej tyre 80 mjek (të ndarë sipas specializimeve Mikrobiologë 27, Epidemiologë 17, Ekologji Humane 14, dhe Shëndet Publik/Mjekësi Sociale 22), 136 infermier/laborant, 14 kimist sanitar dhe 64staf administrativ dhe mbështetës. Me aprovimin e Rregullores Nr.01/2024 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Në Institutin Kombëtar Të Shëndetësisë Publike Të Kosovës planifikohen 346 punëtorë varësisht nga aprovimi i qarkores së parë dhe të dytë buxhetore. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2025 është 5,501,325.76€.

## Hyrje

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike është institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor, që organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë. IKSHPK me 6 departamentet e veta (Departamenti i Epidemiologjisë (DE), Departamenti i Mjekësisë Sociale (DMS), Departamenti i Mikrobiologjisë (DM), Departamenti i Ekologjisë Humane (DEH), Departamenti i Statistikave Shëndetësore (DSSH), Departamenti për Financa dhe shërbime të përbashkëta (DF)) mbulon gjithë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degëve të veta – Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) të organizuara në: Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë.

Misioni i IKSHPK është të përmirësojë shëndetin e popullatës përmes monitorimit të gjendjes shëndetësore, parandalimit të sëmundjeve, promovimit të praktikave të shëndetshme, dhe përgjigjes efektive ndaj emergjencave shëndetësore. IKSHPK angazhohet në kërkime shkencore për të identifikuar faktorët që ndikojnë në shëndetin publik dhe zhvillon politika të bazuar në prova për të mbështetur vendime të informuara shëndetësore si dhe mbështet arsimin në fushën e shëndetësisë publike.

IKSHPK veprimtarinë e vet e bazon në Ligjin për Shëndetësi, Ligjin për Shëndetësi Publike, Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe ligjet e aktet tjera juridike në fuqi duke ofruar shërbime në kuadër të shëndetësisë publike, edukim dhe avancim profesional të kuadrit shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve profesional dhe, punë kërkimore shkencore në lëmi të shëndetësisë publike. IKSHPK bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në hartimin dhe zbatimin e politikave të shëndetësisë publike, në bashkërendim me Ministrinë e shëndetësisë.

Ky Plan i Performancës reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për sektorin e shëndetësisë, të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025, Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2032 si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) e nënshkruar me Bashkimin Evropian.

## Objektivat e Planit të Performancës të IKSHPK për vitin 2025:

- Objektiva 1. Përmirësimi i cilësisë dhe i qasjes në shërbime shëndetësore (25 aktivitete)
- Objektiva 2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit (42 aktivitete)
- Objektiva 3. Siguria Shëndetësore (10 aktivitete)

## Është paraparë realizimi i 77 aktiviteteve, të ndara sipas departamenteve:

- Departamenti i Ekologjisë Humane, 4 aktivitete
- Departamenti i Epidemiologjisë, 15 aktivitete
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përbashkëta, 6 aktivitete
- Departamenti i Mikrobiologjisë, 15 aktivitete
- Departamenti i Mjekësisë Sociale, 12 aktivitete
- Departamenti i Statistikave Shëndetësore, 13 aktiviteteve
- Divizioni i Prokurimit, 8 aktivitete
- Divizioni i Burimeve Njerëzore, 4 aktivitete

## Resurset njerëzore

IKSHPK për vitin 2025 ka të aprovuar gjithsej 306 të punësuar, prej tyre mjek specialist 81, (Epidemiolog 16, Mikrobiolog 29, Higjienë/ekologji Humane 14, Shëndet Publik/Mjekësi Sociale 22), infermier/laborant 136, kimist sanitar 14, staf administrativ dhe mbështetës 64.

## Buxheti

IKSHPK për vitin 2025 ka në dispozicion 5,501,325.76€ nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Për paga dhe shtesa janë planifikuar 3,707,227.76€, për mallra dhe shërbime 1,488,050.00€, për shpenzime komunale 156,048.00€ ndërsa për shpenzime kapitale 150,000.00€. Për realizimin e planit të performancës, përpos aktiviteteve të rregullta të mbuluara nga BKK, janë paraparë edhe aktivitete shtesë të kostuara në dokumentet përkatëse strategjike nga ku rrjedhin këto aktivitete. Këto shpenzime shtesë arrijnë vlerën 4,158,819€, të ndara sipas objektivave:

- Objektiva 1: 4,850€
- Objektiva 2: 3,976,919€ (prej tyre, për vaksina 3,518,269 për vaksina të finansuara nga MSH)
- Objektiva 3: 177,050€

**Sfidat**

Ndër sfidat e IKSHPK për vitin 2025 parashihet të jetë zbatimi i Rregullores se re nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, themelimi i QRSHP të Prishtinës, sigurimi i resurseve njerëzore të nevojshme për ristrukturimin e IKSHPK/QRSHP-ve, mirëmbajtja e objekteve dhe përmirësimi i kushteve të punës, edukimi i vazhdueshëm profesional si dhe kufizimet buxhetore në raport me nevojat dhe dëshirat.

Me respekt,

| PLANI I PUNËS (PERFORMANCËS) 2025 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Data:** | 15.01.2025 | | | | | |
| **AGJENCIA** | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës | | | | | |
| **MINISTRIA PËRGJEGJËSE** | Ministria e Shëndetësisë | | | | | |
| ***Misioni i Agjencisë*** | Misioni i Institutit për Shëndetësi Publike është të përmirësojë shëndetin e popullatës përmes monitorimit të gjendjes shëndetësore, parandalimit të sëmundjeve, promovimit të praktikave të shëndetshme, dhe përgjigjes efektive ndaj emergjencave shëndetësore. Instituti angazhohet në kërkime shkencore për të identifikuar faktorët që ndikojnë në shëndetin publik dhe zhvillon politika të bazuar në prova për të mbështetur vendime të informuara shëndetësore si dhe mbështet arsimin në fushën e shëndetësisë publike. | | | | | |
| **Objektivat** | **Treguesi(t)** | **Vlera bazë** | **Vlera e synuar** | **Rezultatet (Outputet)** | **Alokimi financiar** | **Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike** |
| **Objektiva 1. Përmirësimi i cilësisë dhe i qasjes në shërbime shëndetësore** | 1.1 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Burimet njerëzore, Aktivitetet dhe Indikatorët në Spitalet Rajonale për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 1.2 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Burimet njerëzore, Aktivitetet dhe Indikatorët në QKUK për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 1.3 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Vizitat Mjekësore ne KPSH për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 1.4 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Resurseve Humane të KPSH, KDSH dhe KTSH për vitin 2024 (gjendja 31 dhjetor 2024) | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 1.5 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Burimet njerëzore dhe | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aktiviteti i laboratorit mikrobiologjik dhe Ekologji Humane në IKSHPK dhe QRSHP për vitin 2024. | | | | | |
| | 1.6 Kodifikimi i shkaqeve të vdekjeve për vitin 2023 | 0 | 1 | DEM 2 të dorëzuara në ASK (DSSH) | IKSHPK/ Donatorë | Marrëveshja e mirëkuptimit me ASK |
| | 1.7 Trajnimi i profesionistëve shëndetësor për Programin e Kujdestarisë së Antibiotikëve | 0 | 5 | 5 trajnime të zhvilluara në 3 spitale dhe 2 QKMF (DM) | 4,850 | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.4.9 SSSH 2025-2030 |
| | 1.8 Plani i rrjedhës së parasë së gatshme Plani i zotimeve dhe plani i shpenzimeve | 0 | 1 | Plani i rrjedhës së parasë së gatshme Plani i zotimeve dhe plani i shpenzimev e të finalizuar (DF) | BKK | Rregullorja e thesarit |
| | 1.9 Planifikimi lidhur me KASH 2026-2028 | 0 | 1 | Qarkorja buxhetore Q2 për 2026-2028 e dorëzuar (DF) | BKK | LMFPP dhe rregullorja e thesarit |
| | 1.10 Vlerësimi i nevojave financiare për vitet 2026-2028 për IKSHPK | 0 | 1 | Qarkorja buxhetore Q2 për 2026-2028 e dorëzuar (DF) | BKK | LMFPP |
| | 1.11 Raportet tremujore të shpenzimeve dhe përcjellja e ekzekutimit të buxhetit për vitin fiskal 2025 | 0 | 4 | 4 Raporte të shpenzimev e dhe përcjelljes së ekzekutimit | BKK | LMFP |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të buxhetit për vitin fiskal 2025 të dorëzuara në MSH (DF) | | |
| | 1.12 Mbyllja e vitit fiskal 2024 | 0 | 1 | Raporti mbi mbylljen e vitit fiskal 2024 i dorëzuar (DF) | BKK | Rregullorja e thesarit për mbylljen e vitit fiskal |
| | 1.13 Mbikëqyrja e të hyrave të arkëtueshme | 0 | 12 | Raporti mujor i te hyrave te arkëtueshme i dorëzuar (DF) | BKK | Rregullorja e thesarit për të hyrat vetanake |
| | 1.14 Përgatitja e planifikimit përfundimtar të Prokurimit | 0 | 1 | Dorëzimi i planifikimit përfundimtar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe publikimi i tij në ueb faqen e IKSHPK (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik |
| | 1.15 Përgatitja e dosjes së tenderit dhe përshkrimit të çmimeve/paramasës, sipas planifikimit përfundimtar të prokurimit | 0 | 12 | Raporti mujor i aktiviteteve (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.16 Përgatitja e njoftimit për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për nënshkrim të kontratës | 0 | 12 | Raporti mujor i aktiviteteve (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Prokurimin Publik |
| | 1.17 Hapja e tenderëve | 0 | 12 | Raporti mujor i aktiviteteve (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.18 Vlerësimi i tenderëve | 0 | 12 | Raporti mujor i aktiviteteve (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.19 Përgatitja e draft kontratave | 0 | 12 | Raporti mujor i aktiviteteve (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.20 Mbajtja e regjistrit gjithëpërfshirës me të dhënat për secilin aktivitet të prokurimit | 0 | 1 | Regjistri i përditësuar i të dhënave për secilin aktivitet (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.21 Përgatitja e raportit vjetor të kontratave të nënshkruara | 0 | 1 | Dorëzimi i raportit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe te ZKA (DP) | BKK | Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik |
| | 1.22 Përgatitja e planit të Personelit, definimin e vendeve të punës dhe pozitat e lira në IKSHPK | 0 | 1 | Plani i Personelit i miratuar (DBNj) | BKK | Ligji për Zyrtarët Publik, Rregullorja për Planifikimin e Personelit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.23 Zbatimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IKSHPK (DBNj), për pozitat të cilat kanë mjete financiare të alokuara | 4 | 2 | Ristrukturim i katër departamenteve në dy, në IKSHPK dhe QRSHP dhe plotësimi i pozitave të alokuara (DBNj) | BKK | Rregullorja Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm - IKSHPK<br><br>Rregullorja Nr.30/2024 Për Procedurat e Rekrutimit |
| | 1.24 Vlerësimi i nevojave për zhvillim të stafit përmes IKAP | 0 | 1 | Plani i Trajnimeve i dorëzuar në IKAP (DBNj) | BKK | Ligji për Zyrtarët Publik |
| | 1.25 Mbajtja e evidencave të rekrutimit dhe performancës së stafit të IKSHPK. | 0 | 1 | Raporti vjetor i vitit 2024 (DBNj) | BKK | Ligji për Zyrtarët Publik, Statuti i IKSHPK, Rregullorja Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm - IKSHPK |
| **Objektiva 2**<br><br>**Ruajtja dhe përparimi i shëndetit** | 2.1 Krijimi i bazës së të dhënave për regjistrimin e personave përdorues të narkotikëve | 0 | 1 | Forma unike e mbledhjes së të dhënave për raportimin e institucioneve shëndetësor e për persona që trajtohen dhe janë të varur nga barnat narkotike dhe substancat psikotrope e dorëzuar në | 5,450 MSH/MPB | Strategjia shtetërore kundër drogave 2024-2028 dhe Plani i veprimit 2024-26 Obj. sp. 2.9 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | MSh (DSSH) | | |
| | 2.2 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Sëmundjet malinje te raportuara për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.3 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Sëmundjet kronike jo ngjitëse të raportuara për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.4 Përgatitja e vjetarit për morbiditetin e KDSH dhe KTSH për vitin 2024. | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (varet nëse SHSKUK do ti raportojë anekset) (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.5 Përgatitja e vjetarit për morbiditetin e KPSH për vitin 2024. | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.6 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Insulinovartësit në Institucionet e KPSH 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.7 Përgatitja e Vjetarit të Statistikave Shëndetësore: Lindjet në institucionet shëndetësore për vitin 2024 | 0 | 1 | Vjetari i publikuar (DSSH) | BKK | SSSH, dhe UA 11/2013 për SISH |
| | 2.8 Hartimi i planit vjetor për promovim dhe edukim shëndetësor në bashkësi | 0 | 1 | Një (1) plan veprimi i miratuar dhe zbatuar (MS) | 4,850 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, objektivi 2.2.6 SSSH 2025-2030 |
| | 2.9 Trajnimi i trajnerëve për promovim dhe edukim shëndetësor | 0 | 60 | 60 trajner të trajnuar (MS) | 4,850 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | objektivi 2.2.7 SSSH 2025-2030 |
| | 2.10 Organizimi i konferencës rajonale për promovim dhe edukim shëndetësor | 0 | 1 | 1 Konferencë e organizuar (MS) | 30,000 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, objektivi 2.2.8 SSSH 2025-2030 |
| | 2.11 Hartimi i procedurës operative standarde për raportim të aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor nga të gjitha nivelet | 0 | 1 | Një (1) procedurë standarde operative e miratuar dhe zbatuar (MS) | 4,850 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, objektivi 2.2.9 SSSH 2025-2030 |
| | 2.12 Organizimi i aktiviteteve edukative shëndetësore për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian | 0 | 5 | Pesë (5) aktivitete edukative në vit të zhvilluara (MS) | 5,000 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, objektivi 2.2.11 SSSH 2025-2030 |
| | 2.13 Hartimi i planit të trajnimeve për promovim shëndetësor | 0 | 1 | Një (1) plan i trajnimeve i miratuar dhe zbatuar (MS) | 4,850 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023- 2025, objektivi 2.2.14 SSSH 2025-2030 |
| | 2.14 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për edukim dhe promovim shëndetësor | 0 | 3 | 3 fushata vetëdijësues e të organizuara (MS) | 30,000 | Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023-2025 3.3 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.15 Trajnime të profesionistëve nga tri nivelet e kujdesit shëndetësor për kontrollin dhe menaxhimin e Sëmundjeve Kronike Jo ngjitëse (përfshirë trajnimet për Këshillimin Motivues) | 0 | 50 | 50 profesio-nistë shëndete-sorë të trajnuar (MS) | 5,000 | Plani i veprimit për sëmundjet kronike jo ngjitëse 2023-2025 1.13 |
| | 2.16 Hulumtimi GYTS/GSPS | 0 | 1 | Hulumtimi i realizuar (MS) | 50,000 | Plani i veprimit për sëmundjet kronike jo ngjitëse 2023-2+H18025 1.13 |
| | 2.17 Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës | 0 | 1 | Analiza e gjendjes shëndetësor e të popullatës e publikuar (MS) | BKK | Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025; SSSh 2023-2030; PV i PESh 2023-2025; PV i SKJ 2023-2025; 1.1 |
| | 2.18 Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë | 0 | 1 | Raporti i gjendjes perinatale e publikuar (MS) | BKK | Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025; SSSh 2023-2030; PV i PESh 2023-2025; PV i SKJ 2023-2025; 1.2 |
| | 2.19 Shënimi i Ditëve Botërore në lidhje me shëndetin | 0 | 8 | 8 Ditë Botërore të shënuara (MS) | 30,000 | Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025; SSSh |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 2023-2030; PV i PESh 2023-2025; PV i SKJ 2023-2025; 2.3 |
| | 2.20 Shtrirja e Medlis-it në të gjitha institucionet | 6 | 7 | Sistemi i digjitalizuar Medlis funksional në IKSHPK dhe 6 QRShP (DM)/MSh. | 30,000 | Plani i veprimit për parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbje për pandemitë me patogjenë respiratorë 2024-2026 (PV PGRR PMPR 2024-2026), objektivi 2.3.1 SSSH 2025-2030 |
| | 2.21 Monitorimi i shfrytëzimit të sistemit Digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse | 0 | 12 | 12 raporte mujore të monitorimit të shfrytëzimit të sistemit digjital (DE) | BKK | PV PGRR PMPR 2024-2026, objektivi 2.3.3 SSSH 2025-2030 |
| | 2.22 Mbajtja e shkallës së incidencës me tularemi 0.65/100,000 | 0.56/100,000 Buletin i vjetor 2024 | 0.55/100,000 | Raporti vjetor i situatës epidemiologjike për sëmundjet ngjitëse (DE) | BKK | Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe sistemit shëndetësor 2022, Objektivi 2.5 SSSH 2025-2030 |
| | 2.23 Sigurimi i pajisjeve laboratorike për testime të patogjenëve respiratorë me potencial pandemik | 0 | 1 | Pajisjet mikrobiolo-gjike klinike të siguruara (DM)/MSh | 200,000 | PV PGRR PMPR 2024-2026, objektivi 2.3.4 SSSH 2025-2030 |
| | 2.24 Hartimi i PSO për mbikëqyrje të Influencës, COVID-19 dhe patogjenët | 0 | 1 | PSO e hartuar (DE) | 5,000 | PV PGRR, Objektiva 2 aktiviteti 2.10 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | tjerë respiratorë me potencial pandemik për pjesën humane | | | | | |
| | 2.25 Zgjerimi i qendrave sentinel/ Pika raportuese për mbikëqyrje epidemiologjike dhe virologjike të patogjenëve respiratorë | 5 | 6 | Pika raportuese e zgjeruar (DE) | BKK | PV PGRR, Objektiva 2 aktiviteti 2.17 |
| | 2.26 Hartimi i udhëzuesit për vlerësim të përbashkët të riskut dhe reagim me qasje "Një shëndet" | 0 | 1 | Udhëzuesi për vlerësim të përbashkët të riskut i hartuar (DE) | 5,000 | PV PGRR, Objektiva 2 aktiviteti 2.15 |
| | 2.27 Identifikimi i patogjenëve prioritarë për mbikëqyrje në vend | 0 | 1 | Lista e patogjenëve për mbikëqyrje e identifikuar (DM) | 4,850 | Plani i veprimit strategjik i laboratorit të Kosovës 2024 - 2026, objektivi 2.3.5 SSSH 2025-2030 |
| | 2.28 Përcaktimi i laboratorit (-eve) përgjegjës për mbikëqyrjen gjenomike në vend | 0 | 1 | Vendimi për përcaktim të laboratorit përgjegjës (DM) | 4,850 | Plani i veprimit strategjik i laboratorit të Kosovës 2024-2026, objektivi 2.3.11 SSSH 2025-2030 |
| | 2.29 Sigurimi i vaksinave sipas kalendarit të rregullt | PCV- 39094 BCG- 17320 Hep B pediatrik - 22250 Pentaxim - 54968 Hexaxim - 0 Rota 39304 MMR- | PCV- 50,000 BCG- 30,00 Hep pediatrik - 40,000 Pentaxim- 50,000 Hexaxim- 50,000 Rota- 10,000 | Të gjitha vaksinat e siguruara sipas planifikimit (DE) | 3,454,053 | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 42530 Td-37369 DT -14230 bOPV -23150 HPV-5250 | MMR-40,000 Td-25,000 DT 25,000 bOPV-30,000 HPV-15,000 | | | |
| | 2.30 Sigurimi i vaksinave sipas indikacioneve epidemiologjike | Rabies 156, HIB 18, Hep B adult-15, Pneumovax 23v-112, Meningjiti 1003, Tifoide – 1400, Ethet e verdha – 890, Vakina e gripit 6145, Vaksina a kundër Covid-19-17492 | Rabies-400 doza HIB-50 Hep B adult -8000 Pneumovax 23v-200 Menin git -1700 Ethet e verdhe 300 Tifoide 300 Vaksina a e gripit 85000 Vaksina a e covid-19-2880 doza | Vaksinat e siguruara sipas planifikimit (DE) | 64,216 | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026 |
| | 2.31 Përditësimi i plan programit të vaksinimit | 0 | Plan programi i përditësuar | Plan programi i aprovuar (DE) | BKK | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.32 Shënimi i javës botërore të imunizimit | 0 | 1 | Java botërore e imunizimit e organizuar (DE) | 5,000 | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026 |
| | 2.33 Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve | 0 | 1 | 15% e profesionistëve shëndetësor të trajnuar (DM) | 19,400 | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.3.15 SSSH 2025-2030 |
| | 2.34 Zbatimi i standardeve ndërkombëtare (1 infermier i kontrollit të infeksioneve në 250 shtretër) | 0 | 1 | Një (1) vendim nga institucionet shëndetësore për caktimin e infermierit përgjegjës (DM) | 4,850 | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.3.16 SSSH 2025-2030 |
| | 2.35 Vaksinimi i punëtorëve shëndetësorë me vaksina kundër gripit | 5% e profesionistëve e shëndetësor të vaksinuar, sezona 2023/2024 | 7% e profesionistëve e shëndetësor të vaksinuar, sezona 2025/2026 | Raporti vjetor i mbulue-shmërisë me vaksinën kundër gripit sezonal (DE) | BKK | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.3.17 SSSH 2025-2030 |
| | 2.36 Numri i punëtorëve shëndetësorë të vaksinuar me vaksinën kundër Hepatit B | 500 punëtorë shëndetësorë të vaksinuar me tri doza, 2024 | 600 punëtorë shëndetësorë të vaksinuar me tri doza, 2025 | Raporti vjetor i mbulue-shmërisë me Hepatit B (DE) | BKK | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.3.17 SSSH 2025-2030 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.37 Mbulueshmëria me vaksinim sipas kalendarit të rregullt | 87% e fëmijëve të vaksinuar (DTaP 1, DTaP3, MMR 1) | 90% e fëmijëve të vaksinuar (DTaP 1, DTaP 3, MMR 1) | Raporti vjetor i mbulue-shmërisë sipas kalendarit të rregullt (DE) | BKK | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026,Objektivi 2.1. SSSH 2025-2030 |
| | 2.38 Mbulueshmëria me vaksinën kundër HPV (11-12 vjeç) | 84% e vajzave të vaksinuara (11-12 vjeç) | 84% e vajzave dhe djemve të vaksinuar (11-12 vjeç) | Raporti vjetor i mbulue-shmërisë kundër HPV (DE) | BKK | Plani i Veprimit për vaksinim 2025-2026 |
| | 2.39 Monitorimi i ekosistemeve për të vlerësuar ndërlidhjen e zoonozave në shkaktimin e sëmundjeve të njerëzit | 0 | 1 | Raporti vjetor i publikuar për zoonozat humane (DE) | 4,850 | Plani strategjik për sëmundjet ngjitëse 2023-2025, objektivi 2.5.8 SSSH 2025-2030 |
| | 2.40 Vlerësimi i kushteve mikroklimatike në amvisëritë e Komunës se Prishtinës | 0 | 20 | Raporti i matjeve fiziko kimike dhe parametrave të komforit në amvisëritë (EH) | BKK | Monitorimi i Cilësisë së Ajrit në Mjediset e Brendshme Sipas OBSH |
| | 2.41 Përcjellja e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit | 0 | 1 | Raporti vjetor për kualitet dhe siguri të ushqimit (EH) | BKK | Statuti IKSHPK |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.42 Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm në Kosovë | 0 | 12 | 12 Raporte mujore për cilësinë e ujit për pije në Kosovë (EH) | BKK | QRK/UA 10/2021 Cilësia e Ujit të destinuar për konsum nga njeriu |
| **Objektiva 3**<br><br>**Siguria Shëndetësore** | 3.1 Hartimi i PSO për shkëmbim të informacioneve në mes sektorëve human, animal, ushqimor dhe mjedisor | 0 | 1 | PSO e Aprovuar (EH) | 2,100 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024 - 2026, objektivi 4.1 |
| | 3.2 Hartimi i Programit për biombrojtje dhe biosiguri në sistemin e laboratorëve IKShPK/QRShP | 0 | 1 | Programi i aprovuar (DM) | 20,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 5.2 |
| | 3.3 Trajnim për biosiguri dhe biombrojtje me personelin laboratorik IKShPK/QRShP | 0 | 1 | 1 Trajnim për 10 pjesëmarrës nga laboratori IKSHPK/ QRSHP (DM) | 12,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 5.3 |
| | 3.4 Trajnim për largimin e sigurtë të mbeturinave laboratorike IKSHPK/QRSHP | 0 | 1 | 1 Trajnim i realizuar për 10 pjesëmarrës të ftuar nga laboratori IKSHPK/ QRSHP (DM) | 50,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 5.4 |
| | 3.5 Emërimi me detyra specifike të punës të zyrtarëve për biosiguri IKSHPK/QRSHP | 0 | 2 | Dy zyrtarë të emëruar me detyra specifike të punës të zyrtarëve për biosiguri IKSHPK (DM) | BKK | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 5.5 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.6 Mirëmbajtja e kabineteve të biosigurisë të nivelit 2 në IKShPK | 0 | 5 | Kabinete të mirëmbajtur të biosigurisë së nivelit 2 (DM) | 50,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 5.6 |
| | 3.7 Hartimi i Manualit për menaxhimin e cilësisë në laboratorë | 0 | 1 | Manuali i hartuar (DM) | 10,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 6.3 |
| | 3.8 Hartimi i 10 PSO për shërbime laboratorike mikrobiologjike | 0 | 10 | 10 PSO të aprovuara (DM) | 5,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 6.4 |
| | 3.9 Trajnimet e stafit të laboratorëve për gatishmëri në rast të emergjencave të shëndetit publik | 0 | 1 | Staf i trajnuar për gatishmëri në rast të emergjencave të shëndetit publik (DM) | 20,000 | Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026; 6.5 |
| | 3.10 Hartimi i PSO për koordinim ndër sektorial në rast të emergjencave të shëndetit publik | 0 | 1 | PSO e hartuar (DE) | 7,950 | 2025 Plani për siguri shëndetësore Objektiva specifike 1 Aktiviteti 1.2 |

Dr. Ardita Baraku
Drejtor Ekzekutiv, IKSHPK

Njësia Përgjegjëse